



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:240761
Datë: 03.11.2023
Numri i dokumentit: 04878904

C.nr.797/18

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË- Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren Rezarta Sylejmani Voca, në çështjen juridike kontestimore të paditësit G.. M.. nga P.., te cilin sipas autorizimit e përfaqëson av. Z.. K.. nga P., kundër të paditurës së parë Q.. e R.. së K.., të cilën e përfaqëson nga Avokatura Shtetërore e Kosovës, N.. K., juriste, dhe të paditurës së dytë K.. Gj.. i K., me seli në P., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson B.. M., jurist, me objekt të padisë kompensim i dëmit, pas përfundimit të seancës së shqyrtimit kryesor publik me datë 16.10.2023 , më datën 03.11.2023 morri këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit G.. M.. nga P., me të cilën ka kërkuar nga e paditura Q.. e R.. së K.. dhe e paditura K.. Gj.. i K., të detyrohen në mënyrë solidare t’ia kompensojnë dëmin material dhe jo material, ashtu që në emër të dhimbjeve shpirtërore të përjetuara për shkak të cenimit të autoritetit, nderit, reputacionit si dhe frikës së përjetuar, si rezultat i zhvillimit të procedurës penale ndaj tij nga Prokuroria e Shtetit, t’ia kompensojnë shumën prej 20,000.00 €, dhe në emër të shpenzimeve të krijuara në procedurë penale në emër të mbrojtjes nga avokati, t’ia kompensojnë shumën prej 1,000.00€, me kamatë ligjore prej 8 % nga dita e nxjerrjes së aktgjykimit e deri në pagesën definitive, si e pa bazuar.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

I. Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Paditësi pranë kësaj gjykate, me datë 12.03.2018, ka parashtruar padi kundër të paditurës Q.. e R.. së K., me objekt të padisë kompensim i dëmit si pasojë e zhvillimit të procedurës penale ndaj tij. Në padi ka theksuar se me aktvendimin e Prokurorisë Themelore në Prishtinë- Departamenti për Krime të Rënda PP.I.nr.449/14 kanë filluar hetimet ndaj tij për shkak te veprës penale “Shpërdorim i pozitës zyrtare apo autorizimi” nga neni 339 i KPK-se dhe veprës penale “përdorimi pa autorizuar i pasurisë” nga neni 324 i KPK-së, ku më nga ana e Prokurorisë është ngritur edhe aktakuza. Si rezultat i procedurës penale te zhvilluar ndaj tij, ka theksuar se ka pësuar dëme materiale për faktin se është suspenduar nga puna kurse dëm jo material ka pësuar si rezultat i dhimbjeve shpirtërore për shkak te frikës së përjetuar duke mos ditur epilogun e procedurës, dëmtimit te imazhit në publik, te nderit si intelektual, shkrimtar, profesor universitar, publicist etj. Me propozim që të aprovohet padia dhe kërkesëpadia e paditësit si e

bazuar dhe te detyrohet e paditura për shkak te veprimeve te kundërligjshme të organit - Prokurorisë së Shtetit, i cili e ka udhëhequr procedurën penale, ne emër të dëmit material t'ia paguaj shumën prej 3,435 euro, kurse ne emër te demit jo material, sipas precizimit të lartësisë së kërkesëpadisë që do të bëhet gjatë procedurës, sipas të gjeturave nga eksperti i lemisë së psikiatrisë, të gjitha këto me kamatë ligjore si për mjetet e deponuara në bankë, pa destinim të caktuar.

Me parashtresën e datës 18.04.2023, ka bërë precizimin e kërkesëpadisë, ashtu që në emër të dëmit material ka kërkuar kompensimin në shumën prej 1,000.00 euro, për shpenzimet e krijuara ne emër te mbrojtjes në procedurë penale kurse ne emër të dëmit jo material për shkak te vuajtjeve shpirtërore për shkak te procedurës penale të zhvilluar kundrejt tij, për çka ka marrë dhe trajtim psikiatrik, ka kërkuar kompensimin në shumën prej 20,000.00 euro, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% nga dita e marrjes së aktgjykimit e deri ne pagesën definitive.

Përgjatë seancave të shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare, i autorizuari i paditësit ka theksuar se e drejta për kompensimin e dëmit material dhe jo material gjen mbështetje ligjore, pasi që paditësi duke qenë D.. i K.. F.-it, procedura penale e zhvilluar kundër tij është bërë mediatike gjë e cila ka ndikuar në dëmtim të nderit, cenim të imazhit, reputacionit dhe autoritetit. Me propozim që të aprovohet padia dhe kërkesëpadia e paditësit si e bazuar dhe te detyrohet e paditura për shkak te veprimeve te kundërligjshme të Prokurorisë së Shtetit, ne emër të dëmit material t'ia paguaj shumën prej 1,000.00 euro, kurse ne emër te demit jo material shumën prej 20,000.00 euro të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% nga dita e marrjes së aktgjykimit e deri ne pagesën definitive.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Në përgjigjen në padi, përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës së parë ka theksuar se të paditurës i mungon legjitimiteti real pasiv në këtë çështje juridike civile. Ka theksuar se me palën paditëse nuk kanë hyrë në ndonjë raport juridiko civil nga e cila do të krijoheshin të drejta apo detyrime në mes tyre. Ka propozuar që procedura të vazhdohet vetëm në raport me të paditurën K.. Gj.. i K.., si palë e cila ka subjektivitet të vetëm për të qenë e paditur në këtë çështje juridike kontestimore.

Përgjatë deklarimeve të dhëna në seancë, në formë të shkruar, ka mbetur ne tërësi pranë përgjigjes së dhënë në padi, me propozim që padia dhe kërkesëpadia e paditësit në raport me Q.. e R.. së K.., të refuzohet në tërësi si e pa bazuar, në mungesë të legjitimitetit real pasiv.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Paditësi përmes të autorizuarit të tij, me parashtresën e datës 12.03.2020, e ka zgjeruar padinë në aspektin subjektiv krahas te paditurës Q.. e R.. së K.., edhe në raport me të paditurën K.. Gj.. i K.., me seli në P.. Gjykata përmes njoftimit për zgjerimin e padisë të datës 14.11.2022, lidhur me parashtresën e deponuar nga paditësi e ka njoftuar K.. Gj.. të K..

Pasi zgjerim i padisë nuk është kundërshtuar, K.. Gj.. i K.., në përgjigjen e dhënë në padi, gjatë deklarimeve përgjatë seancave gjyqësore si dhe në fjalën përfundimtare e ka kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si për nga baza po ashtu edhe për nga lartësia si dhe njëkohësisht e ka kontestuar mungesën e legjitimitetit real pasiv të palës në procedurë. Me propozim që padia dhe kërkesëpadia e paditësit në raport me K.. Gj.. të K.. të refuzohet në tërësi si e pa bazuar.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

II. Provat e administruara lidhur me vërtetimin e gjendjen faktike

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike sipas propozimit të palëve ka zhvilluar procedurën e të provuarit dhe ka administruar provat: vendimi nr.555/2013 i dt.17.04.2013, lëshuar nga S.. i P.. i M.. së K.., R.. dhe S.., vendimi nr.118/2015 i dt.18.02.2015, lëshuar nga S.. i P.. i M.. së K.., R.. dhe S.., artikulli i datës 14.01.2014, i datës 18.02.2015 – G.. B.. S.., aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë P.nr.242/2015 i datës 01.07.2016, kontrata për dhënien e mbrojtjes në mes të G.. M.. dhe Z.. K.. e dt.13.10.2014, parashtrësia e dt.18.04.2023, kërkesa për kompensimin e dëmit material dhe jo material nga paditësi për K..-në e dt.13.02.2017 si dhe lexohet aktvendimi nr.09/25 i datës 01.14.2017 nga Komisioni për Kompensimin e Dëmit personave të dënuar pa arsye dhe personave të hequr pa bazë nga liria e K..-së, formularët – pagesat nga M.. e K.., R.. dhe S.. në shumën prej 3,185.00 euro.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të nxjerra në kuptim të nenit 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit duhet refuzuar në tërësi si e pa bazuar.

Nga provat shkresore të administruara, por edhe nga pohimet e palëve ndërgjyqëse, para gjykatës rezultoi të jetë fakt i pa kontestuar se ndaj paditësit është zhvilluar procedura penale, me paraqitjen e kallëzimit penal fillimisht, e më pas me ngritjen e aktakuzës nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, për shkak të dyshimit të kryerjes së veprës penale “shpërdorim” nga neni 257 par.1 I KPK-së.

Me leximin e Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.242/2015 i datës 01.07.2016, gjykata gjeti se paditësi ishte liruar nga akuza për veprën e penale e cila është vënë në barrë dhe atë shpërdorim nga neni 257 par.1 i KPK-së kurse M.. e K.., R.. dhe S.. është udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike.

Me leximin e kërkesës së datës 13.02.2017, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi i është drejtuar me kërkesë për kompensim të dëmit material dhe jo material, me qëllim të arritjes së Ujdisë Jashtëgjyqësore, të paditurës –K.. Gj.. te K.., respektivisht Komisionit për Kompensimin e dëmit personave të dënuar pa arsye dhe personave të hequr pa bazë nga liria.

Gjykata gjeti se ky komision pas shqyrtimit të kërkesës, me aktvendimin e datës 31.05.2017, ka vendosur ta refuzoj si të pa bazuar kërkesën për kompensim. Komisioni ka gjetur se paditësi përgjatë procedurës penale të zhvilluar ndaj tij, nuk është mbajtur në paraburgim dhe nuk ka qenë i arrestuar ndaj kërkesës së tij nuk ka mbështetje ligjore në dispozitat ligjore të KPPK-së për kompensimin e kërkuar.

Ndërmjet palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese se M.. K.., R.. dhe S.., paditësit i kishte shqiptuar masën e pezullimit parandalues me pagesë prej 50% të pagës, me efekt nga data 18.04.2013, e deri në vendosjen përfundimtare nga organet kompetente. Fakt ky megjithëse jo kontestues, i vërtetuar nga gjykata përmes Vendimit nr.555/2013, të datës 17.04.2013. Me pas i njëjti organ, përmes vendimit nr.118/2015 të datës 18.02.2015, e heqë masën e pezullimit

parandalues me 50% të pagës dhe e kthen paditësin në pozitën e D.. të K.. F.. me të gjitha të drejtat dhe detyrimet, duke e obliguar edhe pagesën e mjeteve që nga marrja e vendimit për pezullim e deri në pagesën definitive.

Nga kontrata e datës 13.10.2014, gjykata ka vërtetuar se paditësi me avokatin Z.. K.. nga P., kanë lidhur kontratë për dhënie e mbrojtjes, me të cilën avokati në cilësi të përfaqësuesit ka marrë për obligim përfaqësimin e paditësit në çështjen penale P.nr.242/2015, kurse paditësi ka marrë për obligim në emër të paradhënies të paguaj shumën prej 1,000.00 me rastin e nënshkrimit të kontratës.

Andaj si çështje kryesore kontestuese mes palëve ndërgjyqëse ishte nëse paditësit i takon e drejta në kompensim për dëmin material dhe jo material, si rezultat i zhvillimit të procedurës penale, që kishte përfunduar me aktgjykim lirues ndaj paditësit, për të cilën gjë, në thelb palët kishin pikëpamje tërësisht të kundërta.

III. Ligji i zbatueshëm

Me dispozitën e nenit 136.1, të LMD-së parashihet se “*kush i shkakton tjetrit dem, ka për detyrë t’i kompensojë*”, dispozita tjetër e këtij ligji neni 140, përcakton se “*fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar demin me dashje apo nga pakujdesia*”.

Gjykata gjeti se procedura penale në raport me paditësin, është zhvilluar nga Prokuroria Themelore në Prishtinë dhe përkundër faktit se nuk ka patur për pasojë privimin e kundërligjshëm të lirisë së paditësit, nuk ka ndodhur me fajin e të paditurave.

Gjykata për më tepër bënë të ditur, se e drejta në kompensim sipas ligjit, u njihet personave të mbajtur, arrestuar dhe paraburgosur, ashtu siç parashihet me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila ka aplikim direkt në Kosovë, duke u integruar përmes nenit 22 par. 7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Sipas nenit 5 par. 5 të kësaj Konvente “*Çdo person që arrestohet ose burgoset në kundërshtim me dispozitat e këtij neni ka të drejtën për të kërkuar dëmshpërblim*.” “Kjo e drejtë parashihet edhe sipas Vendimit të Këshillit Gjyqësor mbi Kriteret e Përgjithshme për Kompensimin e dëmit të Personave të Dënuar ose të Arrestuar pa Arsye datë 03.07.2007, kurse praktika e njëjtte ndiqet edhe Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut e cila njeh të drejtën për kompensim personave të dënuar pa arsye.

Së këndejmi gjykata vlerëson se edhe sipas Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, përkitazi neni 529, të drejtë kompensimi kanë vetëm personat që në çfarëdo forme padrejtësisht janë privuar pa bazë nga liria, ose u është shqiptuar sanksioni penal, e që më vonë sipas mjetit juridik janë liruar, ose akuza është refuzuar. Kurse në rastin konkret, gjykata nuk i ka caktuar paditësit asnjërin nga masat për sigurimin e të pandehurit në procedurë, gjegjësisht nuk është privuar nga liria përmes paraburgimit apo arrestit shtëpiak si dhe nuk është marrë vendim dënues e më pas përmes mjetit të jashtëzakonshëm procedura penale të ketë pushuar, akuza të jetë refuzuar apo të jetë liruar nga akuza. Rrjedhimisht del se procedura e iniciuar dhe e zhvilluar ndaj paditësit, nuk i jep të drejtë këtij të fundit të kërkojë kompensimin e dëmit, si rezultat i mungesës së bazës juridike në të cilën paditësi mbështetet kërkesë padinë.

Mbi bazën e kësaj gjendje faktike të vërtetuar dhe në kuptim të dispozitave ligjore të lartcekura, kërkesëpadinë e paditësit për kompensimin e dëmit jomaterial mbi dhimbjet shpirtërore për frikën e përjetuar, degradim të personalitetit, dinjitetit, autoritetit dhe kërkesëpadinë për

kompensimin e dëmit material, ndaj të paditurave, e ka refuzuar si të pa bazuar, si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi. Gjykata ka arritur në përfundim se themelësia e kërkesëpadiisë nga faktet e treguara në padi nuk gjen mbështetje në ndonjë bazë juridike të vlefshme për kompensimet e kërkuara me padi. Në këtë kuptim, në mungesë të bazës ligjore të vlefshme për kompensimin e kërkuar, gjykata ka refuzuar propozimin e të autorizuarit të paditësit, për nxjerrjen e provës me ekspertizë psikiatrike, duke pasur parasysh ekonomizimin e procedurës.

Krejt në fund, gjykata thekson se Prokuroria Themelore në Prishtinë, pavarësisht se nuk ka qenë palë në këtë procedurë, pretendimi kryesor i paditësit ka qenë se me fajin e këtij subjekti është zhvilluar procedura penale, në mënyrë të kundërligjshme ndaj tij. Lidhur me këtë pretendim, gjykata bënë të ditur se sipas nenit 101 të KPPK-së, prokurori i shtetit për një dyshim të arsyeshëm për një vepër penale ose për disa vepra penale, asnjëra nga të cilat nuk dënohet me më shumë se tre vjet burgim, dhe kur prokurori i shtetit vlerëson se ekziston dyshim i bazuar mirë për të mbështetur aktakuzën, i njëjti mund të ngrit aktakuzë sipas nenit 241 të këtij Kodi. Lidhur me dispozitën nga neni 109 par.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës si dhe neni 7 të ligjit për Prokurorin e Shtetit, parashihen autorizimet dhe përgjegjësitë e Prokurorit të Shtetit për ndjekjen penale të personave të akuzuar për vepër penale.

Gjykata ka vlerësuar edhe theksimet e tjera të palëve ndërgjyqëse, si dhe provat materiale të administruara në këtë proces gjyqësor, por ka gjetur se të njëjtat janë pa ndikim në vendosjen ndryshe nga ajo që është vendosur si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është marrë në kuptim të nenit 450 të Ligjit për procedurën kontestimore pasi që pala paditëse e ka *humbë procesin gjyqësor tërësisht kurse palët e paditura nuk i kanë kërkuar shpenzimet e procedurës.*

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
C.nr.747/18 datë 03.11.2023

G j y q t a r j a

Rezarta Sylejmani Voca

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 dite, pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.